

Emertimi dhe Forma ligjore:

NIPT –i:

Adresa e Selise:

Data e krijimit:

Nr. I Regjistrimit Tregtar

Veprimtaria Kryesore:

“VIANTE Konstruktion” sh.p.k

K47103804L

Gramsh

23.02.2005

33037

Ndertim – Projektim, Rikonstrukcione

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr 2
dhe Ligjit Nr. 9228, date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”)

VITI 2018

Pasqyrat Financiare jane individuale

Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek

Pasqyrat Financiare nuk jane te rumbullakosura

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2018-31.12.2018

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare 22.02.2019

Pasqyra e Pozicionit financiar

AKTIVE	Shenime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Aktivet monetare	4	4,548,287	450,881
Investime		-	-
Të drejta të arkëtueshme			
<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>		48,695,814	115,057,449
<i>Tvsh kreditore</i>		12,733,937	12,057,432
<i>Tatim fitimi I mbipaguar</i>		843,309	271,706
<i>Te tjera</i>		-	-
Totali I te drejtave te arketueshme	5	62,273,060	127,386,587
Inventarët			
<i>Lende e pare dhe materiale</i>		623,904	6,007,033
<i>Parapagime per inventar</i>		-	-
Totali I inventarit	6	623,904	6,007,033
Shpenzime të shtyra	7	155,517	-
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara			
Totali I aktiveve afatshkurtra		67,600,768	133,844,502
Aktive financiare		-	-
Aktivet materiale		-	-
<i>Ndertesa</i>		-	-
<i>Makineri e pajisje</i>		2,649,645	3,006,164
<i>Mjete transporti</i>		13,879,612	17,721,781
<i>Pajisje zyrash</i>		-	-
<i>Te tjera pajisje dhe informatike</i>		977,471	1,029,905
Totali I aktiveve materiale	8	17,506,728	21,757,850
Aktivet biologjike		-	-
Aktive jo materiale:		-	-
Aktive tatimore të shtyra		-	-
Kapitali i nënshkruar i papaguar		-	-
Total Aktive		85,107,496	155,602,352

Administratori



Gjergji Bezati

Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj

Pasqyra e Pozicionit financiar

<u>PASIV</u>	<u>Shenime</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrime afatshkurtra:		-	-
<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>		38,531,154	84,653,991
<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		5,171,209	10,290,930
<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>		497,573	486,534
<i>Te pagueshme te tjera</i>		-	500,000
<i>Te pagueshme (divident I paterhequr)</i>		-	25,200,000
Shuma detyrime afatshkurtra	9	44,199,936	121,131,455
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Të ardhura të shtyra		-	-
Provizione		-	-
Total detyrime afatshkurtra		44,199,936	121,131,455
Detyrime afatgjata:		-	-
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Të ardhura të shtyra		-	-
Provizione		-	-
Detyrime tatimore të shtyra		-	-
Total detyrime afatgjata		-	-
Total detyrime		44,199,936	121,131,455
Kapitali dhe Rezervat		-	-
<i>Kapitali i Nënshkruar</i>		34,470,000	1,100,000
<i>Rezerva te tjera</i>		896	23,444,595
<i>Fitim / Humbja e Vitit</i>		6,436,665	9,926,301
Total kapitali aksionar	10	40,907,561	34,470,896
Totali I kapitalit dhe I detyrimeve		85,107,496	155,602,352

Administratori



Gjergji Bezati

Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj

<u>Pasqyra e performances</u>	<u>Shenime</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	11	138,730,207	309,560,923
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	12	1,500,000	931,000
<u>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</u>	13	<u>(46,097,362)</u>	<u>(78,572,137)</u>
<i>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>		(30,604,688)	(51,600,487)
<i>Të tjera shpenzime</i>		(15,492,674)	(26,971,651)
<u>Shpenzime të personelit</u>	14	<u>(28,008,525)</u>	<u>(28,558,182)</u>
<i>Paga dhe shpërblime</i>		(24,000,382)	(24,471,467)
<i>Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		(4,008,143)	(4,086,715)
Zhvlërësimi i aktiveve afatgjata materiale (vlera kontabel e aktiveve të shitura)	15	(1,421,647)	(607,953)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	16	(3,963,599)	(4,224,960)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	17	(51,509,738)	(187,046,718)
<u>Të ardhura të tjera</u>		-	390,250
<u>Zhvlërësimi i aktiveve dhe investimeve financiare</u>		-	-
<u>Shpenzime financiare</u>	18	<u>(1,526,829)</u>	<u>(82,379)</u>
<i>Shpenzime për interesa</i>		-	-
<i>Shpenzime të tjera financiare</i>		936	-
<i>Fitime/humbje nga kurset e kembimit</i>		(876,031)	(56,564)
<i>Te ardhura të tjera</i>		-	-
<i>Gjoha dhe interesa</i>		(651,734)	(25,815)
<i>Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet</i>		-	-
<u>Fitimi/Humbja para tatimit</u>	19	<u>7,702,508</u>	<u>11,789,843</u>
<u>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</u>	19	<u>(1,265,843)</u>	<u>(1,863,542)</u>
<i>Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin</i>	19	(1,265,843)	(1,863,542)
<u>Fitimi/Humbja e vitit</u>	19	<u>6,436,665</u>	<u>9,926,301</u>
<u>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</u>		<u>6,436,665</u>	<u>9,926,301</u>

Administratori



Gjergji Bezati

Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj

(metoda indirekte)

Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare	Shenime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit			
<i>Fitim / Humbja e vitit</i>		7,702,508	11,789,843
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>		3,963,599	4,224,960
<i>Shpenzime te shtyra</i>		(155,517)	2,762,926
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>		-	-
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		1,421,647	1,271,234
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>			
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>		65,685,131	(41,264,438)
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>		5,383,129	1,355,333
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>		(76,931,519)	27,088,798
<i>Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit</i>			
<i>Tatim fitimi I paguar</i>		(1,837,446)	(1,720,884)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		5,231,531	5,507,772
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>		(1,134,125)	(6,020,409)
<i>Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		-	-
<i>Dividentë të arkëtuar</i>		-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(1,134,125)	(6,020,409)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Mjete monetare neto nga aktivitetin e financimit			
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare		4,097,406	(512,637)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		450,881	963,518
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor		4,548,287	450,881

Administratori

Hartuesi i pasqyrave

Gjergji Bezati

Anita Pulaj

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali I regjistruar	Rezerva te tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	1,100,000	14,908,382	8,536,213	24,544,595
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël				
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:				
Fitimi / Humbja e vitit			9,926,301	9,926,301
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:				
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:		8,536,213	(8,536,213)	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike				-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2017	1,100,000	23,444,595	9,926,301	34,470,896
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				-
Fitimi / Humbja e vitit			6,436,665	6,436,665
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:				-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:				-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:	33,370,000	(23,443,699)	(9,926,301)	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike				-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	34,470,000	896	6,436,665	40,907,561

Administratori

Hartuesi i pasqyrave

Gjergji Bezati

Anita Pulaj

SHENIMET SHPJEGUESE**1. Informacion i përgjithshëm**

Shoqëria « VIANTE Konstruksion» shpk është krijuar në datë 23.02.2005 me Vendimin Nr. 33037 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me ortak dhe administrator të vetëm Z. Gjergji Bezati. Kapitali i shoqërisë është 34,470,000 leke dhe kuotat e tij zotërohen 100% nga ortaku I vetëm.

Shoqëria ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit, rikonstruksione dhe gjatë vitit 2018 ka patur mesatarisht 105 të punësuar.

Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas ligjit Nr.9901 datë 14/04/2008 “*Per Tregtaret dhe shoqëritë tregëtare*” statutit të saj dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve.

Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të sigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2018	2017
Euro/LEK	123.42	132.95
USD/ LEK	107.82	111.10

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën

e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

✓ Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

✓ Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

✓ Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

✓ Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

✓ Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

✓ Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

✓ Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

✓ Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitet afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin

e blerjes. Aktivitet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitet.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të Tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitet dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Bilanci Kontabel, Aktivët

4. Aktivët monetare

Aktivët monetare janë në shumën 4,548,287 leke, të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Nr	Likujditete	Viti 2018	Viti 2017
1	Depozita në banke	1,890,648	432,767
2	Para në arke	2,657,639	18,114
	Totali	<u>4,548,287</u>	<u>450,881</u>

Depozitat në banke në monedhë të huaj janë të konvertura me kursin e datës 31.12.2018, diferencat nga kursi i këmbimit janë të pasqyrura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

5. Të drejta të arketueshme

Paraqitet shuma e të drejtave të arketueshme deri më 31.12.2018, prej 62,273,060 leke, si më poshtë:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Klient për shitje e shërbime	48,695,814	115,057,449
2	Tvsh	12,733,937	12,057,432
3	Tatim fitimi I mbipaguuar	843,309	271,706
	Totali	<u>62,273,060</u>	<u>127,386,587</u>

6. Inventarët

Në këtë post paraqitet më 31.12.2018 inventari i materialeve në shumën 623,904 leke, si më poshtë:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Materiale ndertimi	623,904	6,007,033
	Totali	<u>623,904</u>	<u>6,007,033</u>

Gjendja e materialeve është vlerësuar me koston e blerjes. Gjate vitit 2018 nuk është ndryshuar mënyra e mbajtjes së inventarit e cila vazhdon të jetë me kosto mesatare.

7. Shpenzime të shtyra

Në këtë post paraqitet më 31.12.2018 shpenzime të cilat i përkasin periudhave të ardhshme në shumën 155,517 leke, si më poshtë:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Shpenzime të shtyra	155,517	-
	Totali	<u>155,517</u>	<u>-</u>

8. Aktive materiale

Aktivët afat gjatë materiale janë të paraqitura me koston e blerjes minus amortizimin e vitit. Vlera kontabel e tyre është 17,506,728 leke, sipas tabelës së mëposhtme :

Nr	Emertimi	Mjete Transporti	Makinëri e pajisje	Te tjera në shfrytëzim	Totali
I	Aktive afat gjatë materiale				
1	Gjendja më 31.12.2017	26,948,715	5,229,137	2,056,050	34,233,901
2	Shtesat për 2018	952,500	-	181,625	1,134,125
3	Paksimet për 2018	(1,939,347)	-	-	(1,939,347)
4	Gjendja më 31.12.2018	<u>25,961,868</u>	<u>5,229,137</u>	<u>2,237,675</u>	<u>33,428,679</u>

II Amortizimi I AQT-ve				
1 Gjendja me 31.12.2017	9,226,933	2,222,973	1,026,145	12,476,051
2 Shtesat per 2018	3,373,021	356,519	234,059	3,963,599
3 Paksimet per 2018	(517,698)	-	-	(517,698)
4 Gjendja me 31.12.2018	<u>12,082,256</u>	<u>2,579,493</u>	<u>1,260,204</u>	<u>15,921,953</u>
III Vlera neto 31.12.2018	<u>13,879,612</u>	<u>2,649,645</u>	<u>977,471</u>	<u>17,506,728</u>

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017.

Bilanci Kontabel, Pasivet

9. Detyrime afatshkurtra

Detyrimet afatshkurtra te shoqerise me 31.12.2018 paraqiten ne shumen 44,199,936 leke, si me poshte :

Nr	Detyrimet afatshkurtra	Viti 2018	Viti 2017
1	Detyrime per Furnitore	38,531,154	84,653,991
2	Detyrime per paga	5,171,209	10,290,930
3	Detyrime tatimore	497,573	486,534
4	Hua te marra nga shoqeria	-	500,000
5	Divident I paterhequr	-	25,200,000
	Totali I detyrimeve	<u>44,199,936</u>	<u>121,131,455</u>

9.1 Detyrime per Furnitore

Paraqitet gjendja e palikujduar e furnitoreve me 31.12.2018 ne shumen 38,531,154 leke. Vlerat e tyre ne monedha te huaja jane konvertuar me kursin e dates 31.12.2018 te Bankes se Shqiperise dhe diferencat jane kontabilizuar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas SKK-ve.

9.2 Te pagueshme ndaj punonjesve

Paraqitet detyrimi ndaj punonjesve per paga i palikujduar deri me 31.12.2018 ne shumen 5,171,209 leke.

9.3 Të pagueshme për detyrimet tatimore

Jane te paraqitura detyrimene shumen 497,573 leke, me 31.12.2018 sipas tabelës se meposhtme:

Nr	Detyrimet tatimore	Viti 2018	Viti 2017
1	Sigurime shoqerore dhe shendetsore	486,357	478,828
2	Tatimi mbi te ardhurat personale	10,010	6,500
3	Tatim ne burim	1,206	1,206
	Totali I detyrimeve	<u>497,573</u>	<u>486,534</u>

10. Kapitali

Gjate vitit 2018 jane shtuar kapitalet e veta me fitimin e vitit ne shumen 6,436,665 leke. Shoqeria ka regjistruar ne QKB proceduren per zmadhimin e kapitalit te saj ne shumen 33,370,000 leke, duke arritur kapitali i regjistruar i saj ne shumen 34,470,000 leke. Totali i kapitaleve te veta te shoqerise me 31.12.2018 eshte 40,907,561 leke.

Nr	Emertimi	Kapitali I nenshkruar	Rezerva te tjera	Fitimi I vitit	Totali
1	Gjendja me 31.12.2017	1,100,000	23,444,595	9,926,301	34,470,896
2	Shtesat per 2018	33,370,000		6,436,665	39,806,665
3	Pakesimet per 2018	-	(23,443,699)	(9,926,301)	(33,370,000)
	Gjendja me 31.12.2018	<u>34,470,000</u>	<u>896</u>	<u>6,436,665</u>	<u>40,907,561</u>

PASH-Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

11. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Te ardhurat e realizuara nga aktiviteti i shoqerise per vitin 2018 jane 138,730,207 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Te ardhura nga aktiviteti	138,730,207	309,560,923
	Totali I te ardhurave	<u>138,730,207</u>	<u>309,560,923</u>

Sqarim per raportimin e shitjeve ne rubriken “Furnizime me shkalle 0%”:

Ju sqarojme se shuma e te ardhurave prej 67,345,859 leke, e raportuar ne rubriken “Furnizime me shkalle 0%” perfaqeson vleren e sherbimeve qe shoqeria ka kryer per punimet ne Hidrocentralin e Banjes, per shoqerine “Limak” shoqeri nenkontraktore e “Devoll Hydropower”, e cila ka te drejte te emeruje nenkontraktore te nivelit te 2-te (Viante Konstruksion), nga ku lind e drejta per te pergatitur fatura te cilat do te jene me TVSH 0% dhe do te pasqyrohen ne rubriken “Furnizime me shkalle 0%” me shenimin perkates “Sipas regjimit specifik të TVSH-së sipas ligjit Nr. 105/2013 date 28.03.2013”.

12. Te ardhura te tjera te shfrytezimit

Te ardhurat e realizuara nga shitja e aktiveve te shoqerise per vitin 2018 jane 1,500,000 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Te ardhura nga shitja e aktiveve	1,500,000	931,000
	Totali I te ardhurave	<u>1,500,000</u>	<u>931,000</u>

13. Lenda e pare dhe Materiale te konsumueshme

Shuma e materialeve te konsumuara per vitin 2018 eshte 46,097,362 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Materiale te para	25,221,559	50,245,154
2	Ndryshimi I gjendjes	5,383,129	1,355,333
	Shuma I	<u>30,604,688</u>	<u>51,600,487</u>
	Te tjera shpenzime		
1	Karburant	15,357,574	26,791,066
2	Materilae ndihmese	-	75,068
3	Kancelari	135,100	105,517
	Shuma II	<u>15,492,674</u>	<u>26,971,651</u>
	Shuma I+II	<u>46,097,362</u>	<u>78,572,137</u>

14. Shpenzime te personelit

Shpenzimet per personelin ne shumen 28,008,525 leke jane te detajuara si me poshte:

Nr	Kosto e Punes	Viti 2018	Viti 2017
1	Shpenzime per paga	24,000,382	24,471,467
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	4,008,143	4,086,715
	Shuma	<u>28,008,525</u>	<u>28,558,182</u>

15. Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale

Jane llogaritur shpenzimet per vleren aktiveve te shitura ne shumen 1,421,647 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Zhvleresimi I aktiveve	1,421,647	607,953
	Shuma	<u>1,421,647</u>	<u>607,953</u>

16. Shpenzime Konsumi dhe Amortizimi

Jane llogaritur shpenzimet per amortizimin e aseteve sipas normave ligjore ne fuqi per 3,963,599 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Amortizimi I aktiveve	3,963,599	4,224,960
	Shuma	<u>3,963,599</u>	<u>4,224,960</u>

17. Shpenzime te tjera shfrytezimi

Ne kete ze jane ne shumen 51,509,738 leke, te cilat i perkasin vitit ushtrimor 2018, te detajuara si ne tabelen e meposhtme:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Shpenzime telefonike	177,024	169,696
2	Sherbim kontabiliteti, auditimi, noterie	813,517	1,650,723
3	Sigurime mjetesesh, taksa	102,683	485,228
4	Konsum personal	84,710	-
5	Certifikim personeli	183,500	90,000
6	Sigurim kontrate	47,258	-
7	Transport per blerje	600,000	20,834
8	Qera	60,000	60,000
9	Punime nga nenkontraktore	38,711,873	178,480,305
10	Veshje pune dhe Materilae ndihmese	34,460	530,410
11	Sherbime bankare	34,022	32,016
12	Taksa Lokale	87,000	-
13	Dieta per personelin	8,548,000	-
14	Studim gjeologjik - hidrologjik	-	120,000
15	Riparime mjetesesh	1,998,624	1,972,400
16	Vlera kontabel e Aqt-ve te shitura	-	663,281
17	Te tjera	14,167	8,900
18	Rimarrje shpenzimesh nga 2016	-	2,762,926
19	Sherbim parkim autoveture	12,900	-
	Shuma	<u>51,509,738</u>	<u>187,046,718</u>

Kuadrimi I blerjeve me shpenzimet e paraqitura ne bilanc

Ne tabelen e meposhtme paraqitet kuadrimi i blerjeve te pasqyruara ne FDP mujore me shpenzimet e perfshira ne pasqyrat financiare per vitin 2018.

Nr	Sipas FDP	Shuma ne leke
1	Blerje te perjashtuara	7,236,109
2	Blerje investimi brenda vendit pa tvsh	952,500
3	Blerje nga furnitore vendas	76,474,356
4	Blerje investimi brenda vendit 20%	181,625
	Totali I blerjeve	<u>84,844,590</u>
Nr	Sipas bilancit	
1	Blerje materialesh	25,221,559
2	<i>korrigjohet me Ndryshimin e gjendjes</i>	5,383,129
3	Të tjera shpenzime	15,492,674
3	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	51,509,738
4	Blerje AQT	1,134,125
	Shuma	<u>98,741,225</u>
Nr	Diferenca	<u>13,896,635</u>
1	<i>Sherbime bankare</i>	(34,022)
2	<i>taksa vendore</i>	(87,000)
3	<i>Kalim shpenzime per tu shpendare</i>	155,517
4	<i>Dieta personeli</i>	(8,548,000)
	Shuma	<u>(8,513,505)</u>
	Diference FDP-Bilanc	<u><u>0</u></u>

18. Shpenzime financiare

Paraqiten shpenzime per vitin 2018 ne shumen 1,526,829 leke te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Fitime/humbje nga kursi I kembimit	(876,031)	(56,591)
2	Te ardhura nga interesa bankare	936	27
3	shpenzime per gjoba e penalitete	(308,700)	(25,815)
4	Shpenzime me fatura jo te rregullta	(25,222)	-
5	Tarife per ankimimi per tender	(317,812)	-
	Totali I te ardhurave	<u>(1,526,829)</u>	<u>(82,379)</u>

19. Llogaritja e rezultatit tatimor

Shoqeria per vitin ushtrimor 2018 paraqitet me nje fitim neto prej 6,436,665 leke. Llogaritja e rezultatit tatimor jepet e permbledhur ne tabelen e meposhtme:

Nr	EMERTIMI	VITI 2018	VITI 2017
1	Te ardhura nga aktiviteti	138,730,207	309,560,923
2	Te ardhura te tjera	1,500,000	931,000
3	Totali I te ardhurave	<u>140,230,207</u>	<u>310,491,923</u>
4	Shpenzime	(132,527,699)	(298,702,080)
5	Rezultati I ushtrimit	<u>7,702,508</u>	<u>11,789,843</u>
6	Shpenzime te pazbritshme	<u>736,444</u>	<u>633,768</u>
7	Fitimi I tatueshem	<u>8,438,952</u>	<u>12,423,611</u>
8	Tatimi I fitimit	1,265,843	1,863,542
9	Fitimi neto I periudhes	<u><u>6,436,665</u></u>	<u><u>9,926,301</u></u>

Shpenzimet e pazbritshme ne shumen 736,444 leke, per vitin 2018 jane shpenzime te detajuar si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Gjoha e penalitete	308,700	25,815
2	Vlera e asetit te nxjerre jashteperdorimit	-	607,953
3	Shpenzime pa fature	25,222	-
4	Shpenzime konsum personal	84,710	-
5	Shpenzime ankimimi per tender	317,812	-
	Shuma	<u>736,444</u>	<u>633,768</u>

20. Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2018 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

21. Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Administratori

Gjergji Bezati

Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj